



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 6.

Prishtinë, më 20.01.2015 në orën 9:00.

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqiu, Xhavit Haliti, Luljeta Veselaj- Gutaj, Rustem Mustafa, Blerim Shala, Vjosa Osmani, Ilir Deda, Kujtim Paçaku, Arben Gashi, Valdete Bajrami, dhe Slllobodan Petroviq.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi Teuta Sahatqia – kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve më 24.12.2014, 26.12.201 dhe 29.12.2014;**
- 3. Shqyrtimi dhe miratimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-05 për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetarja pasi konstatoj se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime .

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve më 24.12.2014, 26.12.201 dhe 29.12.2014

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

Shqyrtimi dhe miratimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-05 për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike

Kryetarja: tha se ky projektligj ka qenë në Kuvend edhe mandatin e kaluar në kompetencë të Komisionit për punë të brendshme, kurse në këtë mandat Komisioni ynë është Komisioni Funkcional për shqyrtim. Ky Projektligj ka ngjallur interesim të madh në opinionin e gjerë, ajo që më së tepërmi ngjall frikë është pika ku mund të preket privatësia, e dimë se privatësia është e garantuar me Kushtetutë në nenin 36.3. Nga shoqëria civile kemi marrë raporte me komente dhe sugjerime, si nga Instituti GAP, Flosk dhe nga European Digital Rights.

Direktiva evropiane për privatësi elektronike është shpallur jovalide dhe tani rregullohet me një rregullore të vitit 1995. Ky projektligj ka ndryshime me projektligjin e kaluar dhe bazohet në Kodin e procedurës penale, Ligjin për komunikime elektronike dhe Ligjin për AKI-në.

Nga njësia për hulumtime kemi kërkuar të bëhet një analizë krahasuese të ligjeve të ngjashme me shtetet e rajonit, të cilat rishtas kanë hyrë në BE dhe të disa shteteve tjera të BE-së dhe një raport më të detajuar nga Ministria e Integritetit, pikat në të cilat duhet të kemi një kujdes janë pikat ku duhet bërë dallimi në mes të përgjimit gjyqësor dhe përgjimit për siguri kombëtare. Cenimi i të drejtave fundamentale të njeriut të cilat në çdo rast duhet të ruhet, pastaj vendndodhja apo njësia ndërlidhëse, apo qendra monitoruese për të cilën kemi marrë edhe sugjerime nga shoqëria civile. Autorizimi për përgjim, domethënë institucioni që autorizon, është pikë që Komisioni duhet të fokusohet, pastaj përdorimi i të dhënave, kohëzgjatja e ruajtjes dhe informimi i të përgjuarit.

Ky ligj është kërkuar të miratohet nga shumë raporte ndërkombëtare, në raportin e Komisionit Evropian, në studimin e fizibilitetit, në raportet e progresit në vazhdimësi dhe në Planin e veprimit për MSA-në, nga përfaqësuesi i BE-së në Kosovë dhe udhërrëfyesi për liberalizim të vizave.

Pasi që është mbledhja e parë që shqyrtohet, ne sot duhet të vendosim se a do ta rekomandojmë këtë projektligj për procedura të mëtejme në Kuvend, apo t'i kthehet Qeverisë sepse nuk ka gjasa si i tillë të rregullohet.

Lidhur me këtë e hapi diskutimin.

Xhavit Haliti: mendon se ky ligj më shumë është i mbështetur në rregulla që kanë policinë politike në diktatura se sa një ligj që e meriton një vend demokratik të shqyrtohet dhe të miratohet në përputhje me atë që ne e quajmë të drejta të njeriut dhe transparencë në veprim të të gjitha institucioneve në Kosovë. Ne e kemi një shërbim informativ civil, kemi shërbim të informimit në FSK, kemi policinë që i kanë mundësitë e përdorimit të teknikave të përgjimit, kemi edhe KFOR-in dhe shërbimet e ndryshme që veprojnë në Kosovë e që janë të përjashtuara nga legjislacioni i Kosovës, në kuptimin e asaj që nuk kemi kompetenca se kënd e përgjojnë dhe si e përgjojnë, por besoj se janë shumë më të mirë dhe më të drejtë konform të drejtës së njeriut. Shtoi se me ligj duhet të përcaktohet saktë, kush dhe kur mund ta urdhërojë përgjimin dhe duhet të respektojmë rregullat që ka BE-ja, që kanë vendet demokratike, që urdhri për përgjim të bëhet konform kërkesës që e bënë prokurori i shtetit.

Për t'i ruajtur raportet me qytetarin, i përgjuari 3 muaj apo 6 muaj duhet të njoftohet pasi të jetë kryer përgjimi dhe dosja e përgjimit duhet t'i dorëzohet atij, ose të asgjësohet nga organi përkatës me kërkesë të të përgjuarit.

Në vazhdim tha se zbrazëtira ligjore për përgjime është keqpërdorur në Kosovë, por dua të jem i saktë, jam kundër policisë politike dhe jam kundër krijimit të mekanizmave të cilët e mundësojnë këtë lloj policie të pa emërtuar në ligj. Në këtë ligj duhet të përcaktohet saktë se kur dhe në çfarë rrethanash mund të përgjohet deputeti, kryeministri, ministri, apo presidenti dhe në çfarë rrethanash, si dhe cili institucion duhet ta vendosë këtë çështje, duke shtuar se duhet të ketë mekanizëm të sigurisë së lartë që konstaton se kush duhet përgjuar.

Çështjet që kanë mbetur të pa sqaruara dhe hapura në këtë ligj, janë thjesht çështje të cilat propozuesi i ligjit ja ka lënë vetes si mundësi që të manipulojë në të ardhmen, sepse nuk përcakton shumë çështje.

Ilir Deda: e vlerësoi si të neveritshme së pari se si në këtë Komision vjen një ligj me përbërje të tillë sepse është në shpërputhje të plotë me aquit komunitare dhe shkel Konventën për të Drejtat e Njeriut dhe rrjedhimisht e shkel Kushtetutën e Kosovës, shkel Nenin 36 dhe 40 të Kushtetutës që ka të bëjë me privatësinë e qytetarëve dhe mbrojtjen e burimit për gazetar.

Kodi i procedurës penale e rregullon çështjen e përgjimit dhe ne mund ta kemi për MSA –në liberalizim dhe gjëra tjera një ligj të veçantë teknik se si bëhet përgjimi, por ajo çka na ka ardhur prej Ministrisë së Integritetit është një tendencë për hapjen e një frike masive të qytetarët e Kosovës dhe tendencë për totalitarizëm në vitin 2015. Më tutje shtoj se nenet 9,11,13 dhe 15 të ligjit janë absolutisht të papranueshme dhe ne nuk e dimë se cilat institucione janë institucionet përgjegjëse të cilat merren me këtë lloj përgjimi. Gjykata e Drejtësisë e BE-së nuk lejon të bahen përgjime për 12 muaj, siç është propozuar në këtë projektligj. Nuk ka ndëshkim për institucionet të cilat përgjojnë, do të thotë AKI-ja dhe pse duhet të ndëshkohen operatorët, transparenca e softverit është një problem i madh, sepse këtu mund të vij deri te rrjedhja masive e informative dhe linçim të çdo njeriu të mundshëm në Kosovë.

Në fund propozoi që ky ligj menjëherë të kthehet prapa në Qeveris së Kosovës sepse në këtë formë si është ky ligj është vetëm kthim prapa.

Vjosa Osmani: vlerësoi se ndryshimet në këtë projektligj do të jenë më shumë se 50 për qind dhe sipas rregullave që kemi në Kuvend, në rast se ndryshimet në ligj janë mbi 50 për qind, atëherë konsiderohet ligj i ri.

Natyrisht që ky projektligj i ka disa ndryshime nga ai që ka ardhur më herët, por mospërputhshmëritë janë të mëdha, por pasi që ne jemi përcaktuar si Komision Funksional duhet shikuar edhe përtej përputhshmërisë me Acquis Commmunitare dhe përveç vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë së BE-së ka edhe vendime të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, vendimet e së cilës ne jemi të obliguar t'i respektojmë sipas nenit 53 të Kushtetutës dhe njëra prej atyre vendimeve merret në mënyrë specifike me mbajtjen e të dhënave private të qytetarëve.

Brengë kryesore vlerësoi se është mos përcaktimi i saktë i institucioneve që kanë të drejtë ta bëjnë përgjimin. Deri më tani në Kosovë kemi pasur me mija raste kur policia e Kosovës ka lidhur marrëveshje me kompani telefonike duke tejkalluar në tërësi gjykatat dhe prokurorit dhe vetëm me marrëveshje kanë bërë përgjimet e qytetarëve, pavarësisht që zyrtarët e këtyre kompanive kanë insistuar që duhet vendimi gjyqësor, ata kanë gjetur mënyrën që përsëri të depërtojnë te vendi ku bëhet përgjimi dhe të anashkalojnë tërësisht kërkesën kushtetuese që të ketë vendim gjyqësor. Ne nuk mund ta lejojmë këtë me ligj për deri sa ndalohet me Kushtetutë dhe nuk mund të procedohet për lexim të parë nëse nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe standardet evropiane, sepse siç e dini një direktivë është bazuar tani më është shfuqizuar nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian, kështu që ne nuk kemi asnjë arsye që të bazohemi në një direktivë që është konsideruar se bie ndesh me standardet evropiane, po kemi për obligim t'i shikojmë ato vendime të gjykatave dhe ato të reflektohen në ligjin tonë.

Në fund propozoi që ose ne ta marrim përsipër si Kuvend dhe ta hartojmë, sepse nëse ndryshohet mbi 50% llogaritet si ligj i ri, ose të ja kthejmë Qeverisë dhe të merren parasysh të gjitha këto ndryshime.

Rrustem Mustafa: tha se rrjedhoja e këtij ligji ka filluar mirë, por kur kanë filluar me përdor modele të shteteve të tjera që kanë ligje jo shumë kredibile, atëherë ky projektligj është degraduar deri në atë masë sa që nuk lejojnë me u institucionalizuar përgjimi siç është përmes sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Nëse fillojmë ta amendantojmë, është mjaft e vështirë ta sjellim aty ku duhet. Projektligji duhet të kthehet në Qeveri me rekomandime tona dhe të kërkojmë që të shkohet me modele të shteteve si, Franca, Austria apo Gjermania dhe mos me shkuar me shtete që kanë ligje jo shumë kredibile, me garantuar institucionalizim të përgjimeve

për mes institucioneve, ngase nuk mund t'i kemi tri ligje si model, sepse humb kuptimi dhe nuk besoj se mund të shkojmë te esenca.

Arben Gashi: në diskutimin e tij, vlerësoi se kjo çështje është mjaft komplekse dhe duhet t'i qasemi në thelb dhe thelbi ka të bëjë me atë se a duhet të rregullohet fusha e përgjimit të telekomunikimeve, telekomunikimet përgjohen në Kosovë legalisht, gjysmë legalisht dhe ilegalisht. Sipas tij, kjo fushë duhet të rregullohet, por në mënyrën se si është sjellë ky ligj nuk ka mundësi të rregullohet kjo fushë. Ligji ka probleme të mëdha, duke filluar nga konflikti me ligjet tjera dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Kodin e procedurës penale, Kodin Penal, Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave personale, Ligjin për AKI--në etj.

Shqetësuese dhe problematike në këtë ligj e konsideron nenin 4.6 sepse tha se këtë fushë po e lëmë me një akt më të ultë nënligjor çka është shumë problematike, problem kryesor i ligjit është i përgjithshëm sepse hasim në dy sfida kryesore në konceptin e përgjimit, e para është se ka të bëjë me lirit personale dhe e dyta me sigurinë personale dhe publike, tani ne duhet me e gjetur një mes të artë, ku garantojmë sigurinë personale publike dhe të njëjtën kohë ku garantojmë lirit dhe të drejtat individuale dhe kolektive dhe këtu është problem kryesor se me këto problem është marrë edhe dhe Bashkimi Evropian dhe sistemi i drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe shtetet individuale dhe kjo është dilemë filozofike edhe politike, ku është e drejta jonë dhe cili është rreziku mbi interesin tonë vital dhe duhet të kemi qasje shumë të saktë në mënyrën si e trajtojmë, problem tani lind se kush ka të drejtë neve të na përgjojë, këtu po përmenden Policia dhe AKI-ja dhe të tjera. Kush janë këta të tjerë, tërësia e këtij ligji lë vakum dhe vakumi kryesor ka të bëjë me mënyrën se si i detajizon proceset.

Shërbimet e Policisë dhe shërbimet e AKI-ja janë dy koncepte krejt të ndryshme, sepse shërbimet e policisë kanë të bëjnë për shërbime kriminale, përgjimet bëhen për arsye të luftimit të kriminalitetit dhe mund të përdoren si provë në gjykatë, kurse shërbimet e inteligjencës janë për mbledhje të informacioneve dhe nuk mund të përdoren si provë në gjykatë, sepse këto informacione të mbledhura kanë të bëjnë me parandalimin dhe përgatitjen e sistemit se diçka mund të ndodhë. Në vazhdim si problem që vazhdon e konsideroj edhe nenin 11 dhe 16 dhe me këtë problem që po shihen tha se është shumë problematike me i rekomanduar Kuvendit që të kalojë në parim ligji sepse nuk i plotëson kriteret minimale për të kaluar, por a kemi vullnet ne, mendoj se e kemi vullnetin, por për rrugën se si ta marrë e kemi problemin, ta marrim rrugën duke e propozuar vetë një ligj të ri apo duke ja kthyer Qeverisë me vërejtjet për këto fusha. Agjencitë që kanë të drejtë të kenë qasje në informacion, procedurat që kanë të drejtë qasje në informacion, pse me qenë aktet nënligjore dhe pse mos me u specifikuar në ligj procedura dhe shkatërrimi i informacionit, si bëhet kur bëhet dhe cila është procedura dhe çka konsiderohet legjislacion sekondar sepse është shumë abstrakte se çka nënkupton me legjislacion sekondar.

Mendon se Qeveria ka treguar mungesa të kapaciteteve me u marrë me këtë ligj, a do të merremi ne me këtë punë ? Këtu ka shumë dilema që duhet të vendosën bashkërisht, sepse këtu është në pyetje liria e qytetarëve të Kosovës, por edhe siguria në të njëjtën kohë, duhet rekomanduar seancës që t'i kthehet Qeverisë.

Valdete Bajrami: tha se ligji si tërësi i referohet institucioneve të sigurisë, ne si Komision konsiderohemi si ekspertë të integriteteve, por për çështje të sigurisë pa tjetër do të ishte mirë që në grup punues që u përmend nga kryetarja e Komisionit nëse miratohet, të jetë edhe një anëtar ose ekspert i sigurisë. Në këtë ligj është paraparë edhe mbrojtja e të drejtave të njeriut me Konventën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por siç e dimë në Kosovë përgjimet janë bërë edhe te njerëzit që nuk kanë qenë cak i përgjimeve dhe askush nuk është marrë me mbrojtjen e të drejtave të tyre. Me vërejtjet që u dhanë gjatë kësaj mbledhje, ky projektligj duhet t'i kthehet Qeverisë, duke vlerësuar se ai ka një sërë mangësish.

Blerim Shala: vlerësoi se ky projektligj është i domosdoshëm për Kosovën, por është e domosdoshme që të pësojë ndryshime dhe qartësime thelbësore. Çdo paqartësi lë hapësirë të

keqinterpretimit apo keqpërdorimit, andaj vlerëson se duhet t'i kthehet Qeverisë sepse kemi të bëjmë jo vetëm me të drejta të njeriut, por edhe me siguri kombëtare dhe as ne si Komision dhe as Kuvendi nuk mund të marrë përgjegjësi për hartimin e një ligji të tillë që gjithsesi prek interesat e sigurisë kombëtare. Dihet kush është përgjegjës para opinionit dhe qytetarëve për siguri kombëtare. Ne mund ta bëjmë një draftligj, por përgjegjësia për sigurinë kombëtare i bie Qeverisë së Kosovës, andaj ne mund të përgatisim një listë të tërë me rekomandime dhe sugjerime dhe Qeveria duhet të bëjë përpjekjen e re dhe të na sjellë në Kuvend një ligj duke i marrë parasysh shqetësimet tona dhe të shoqërisë civile.

Kujtim Paçaku: tha se projektligji është i pa definuar mirë dhe duhet të kthehet te sponsorizuesi, sepse mos definimi i tij ka pasur pasoja edhe për gazetarin hulumtues se shumë gazetarë kanë qenë të përgjuar prej policisë politike dhe kjo i ka frikësuar gazetarët ta shprehin drejt informatën.

Sllobodan Petroviq: tha se pajtohet me propozimet e parafolësve se ky ligj ka mangësi dhe paqartësi, sepse ligji duhet të jetë në interes të mbrojtjes të qytetarëve, meqë ndërlidhet me privatësinë e tyre, andaj si i tillë ky Projektligji duhet të kthehet për rihartim në Qeveri.

Vjosa Osmani: theksoi se kur të bëhen rekomandimet për Qeveri, në arsyetim me filluar me mos përputhshmërinë me Kushtetutën, nenin 22, nenin 36 dhe nenin 53.

Kryetarja: tha se u diskutua mjaft për këtë ligj dhe askush nuk e kontestoi që ky ligj i duhet Kosovës, prej shumë folësve u tha se fusha e pa rregulluar si duhet me ligj ka bërë që mundësitë e keqpërdorimit të përgjimit kanë qenë të mëdha. Shpresojmë të rregullohet kjo fushë në afatin sa më të shpejtë, në mënyrë që të ndalen keqpërdorimet.

Pas diskutimeve kryetarja nxori këtë:

Përfundim

Komisioni një zëri nuk e miratoi në parim, Projektligjin Nr. 05/L-05 për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike dhe i rekomandon Kuvendit ta kthejë në Qeveri duke i marrë parasysh rekomandimet që u dhanë nga diskutuesit.

- Ky Projektligj cenon të drejtat themelore të përcaktuara me nenin 36, paragrafi 1 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (E drejta e Privatësisë);
- Në këtë projektligj nuk janë të përcaktuara saktë Institucionet e autorizuar për përgjim, kohën e ruajtjes së përgjimit, si dhe mos përcaktimi se dhe në çfarë rrethanash mund të përgjohet;
- Kategoritë e të dhënave që duhet ruajtur të përcaktuara me këtë projektligj janë bazuar në Direktivën 2006/24 të datës 15 mars 2006 ku neni 5 i kësaj Direktive, është shpallur jo valide nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian.
- Projektligji përcakton se njësitë ndërlidhëse të vendosen brenda Institucionit të AKI-së, ndërsa duhet të jetë brenda operatorëve të rrjetit.

4. Të ndryshme.

Në këtë pikë u diskutua lidhur me angazhimin e ekspertëve për t'i ndihmuar Komisionit, për mbledhjen e radhës u vendos që lista e ekspertëve të cilën e ka Komisioni të plotësohet me propozimet e anëtarëve të Komisionit për ekspertë në fusha të caktuara.

Mbledhja përfundoi në orën 10:20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Teuta Sahatqia